



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 127

Prishtinë, më 24.9.2013, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, , Sevdije Lama, Afërdita Berisha-Shaqiri, Boban Todorović, Daut Haradinaj, Nijazi Idrizi, Salih Morina.

Mungoi : Liburn Aliu, Rasim Demiri.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: sipas listës së nënshkruar nga pjesëmarrësit.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi dhe Flaka Broqi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës ;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 20.9.2013,
3. Shqyrtimi i projektligjit për fshatin Zymi i Hasit,
4. Shqyrtimi i projektligjit për trajtimin e ndertimeve pa leje
5. Të ndryshme.

Kryesuesi Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 20.9.2013

Kryetari i Komisionit konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 20.9.2013.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për fshatin Zymi i Hasit

Kryetari Nait Hasani ftoi të pranishmit nëse kanë ndonjë ndryshim në lidhje me projektligjin në fjalë dhe propozoi Komisionit të miratohen amendamentet si ne vijim :

Amendamenti 1

Në Nenin 1, në rreshtin e dytë fjalia “**fetare kulturore e historike**” zëvendësohet me “**kulturore dhe fetare**”.

Amendamenti 2

Neni 3, riformulohet si në vijim :

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:

1.1. **Trashëgimia kulturore** - trashëgimia arkitekturale, arkeologjike, peizazhet kulturore dhe natyrore, trashëgimia e luajtshme dhe shpirtërore siç është përcaktuar në Ligjet ne fuqi.

1.2. **Planifikimi Rural** - planifikimi për shfrytëzimin, mbrojtjen, rregullimin dhe menaxhimin e hapësirës ose territorit të përkufizuar si “Fshat- Zonë Rurale” me Ligjin për Planifikimin Hapësinor.

1.3. **Promovimi**- aktivitetet reklamuese për të promovuar vlerat e trashëgimisë kulturore me qëllim të rritjes së numrit të vizitorëve dhe njohurive për të.

1.4. **Mbrojtja** - nomenklaturë e masave të mbrojtjes të natyrës juridike me qëllim të ruajtjes së vlerave të trashëgimisë kulturore, siç është parashikuar me Ligjin për Trashëgiminë Kulturore.

1.5. **Konservimi**- krijimi i kushteve të përshtatshme dhe marrjen e masave paraprake për ruajtjen e trashëgimisë kulturore, duke përfshirë edhe mirëmbajtjen, siç parashihet me Ligjin për Trashëgiminë Kulturore.

1.6. **Plani i Konservimit** - dokument i planifikimit hapësinor për konservimin, përdorimin dhe zhvillimin në të ardhmen të një hapësire me vlera të trashëgimisë kulturore.

1.7. **Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve të Prizrenit**- Institucion kompetent për Mbrojtjen e Monumenteve në Prizren.

1.8. **Fshati**- Fshati Zymi i Hasit të Komunës së Prizrenit.

1.9. **ZVM**- Zona e veçantë të mbrojtur të fshatit Zymi i Hasit siç përkufizohet me Ligjin për Zonat e Veçanta të Mbrojtura, Ligjin për Trashëgiminë Kulturore dhe Ligjin për Planifikim Hapësinor.

1.10. **Këshilli**- Këshilli për fshatin Zymi i Hasit, i themeluar nga Kuvendi i Komunës së Prizrenit në pajtim me këtë Ligj.

1.11. **Komuna**- Komuna e Prizrenit ashtu siç është përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale.

1.12. **Kuvendi i Komunës** -organi më i lartë i Komunës së Prizrenit që përbëhet prej anëtarëve të tij të zgjedhur siç është përkufizuar në Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale.

1.13. **PZHK**- Plani Zhvillimor i Komunës së Prizrenit.

Amendamenti 3

Neni 4, riformulohet si në vijim :

Këshilli

1. Këshilli përfaqëson interesat e Fshatit në fushën e mbrojtjes dhe promovimit të trashëgimisë **kulturore dhe fetare** si dhe në fushën e planifikimit **hapësinor dhe rural**.

2. Këshillin e themelon Kuvendi i Komunës në pajtim me Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale.

3. Këshilli përbëhet prej 5 anëtarëve:

3.1. tre (3) anëtarë zgjedhën drejtpërdrejtë nga banorët e fshatit të Zymi i Hasit ;

3.2. dy (2) anëtarë zgjedhën nga Kuvendi i Komunës;

4. Zgjedhja e Këshillit organizohet nga Kuvendi i Komunës përmes ftesës publike në pajtim me legjislacionin në fuqi.

5. Anëtarët e Këshillit zgjedhën me mandatin e njëjtë të anëtarëve të Kuvendit të Komunës me të drejtë rizgjedhjeje.

6. Kuorumi për të gjitha takimet e Këshillit përbëhet prej shumicës së thjeshtë të Anëtarëve të Këshillit.

7. Këshilli mund të marr vendim nëse për të voton shumica e anëtarëve që janë të pranishëm.

8. Këshilli e zgjedh Kryetarin e Këshillit nga anëtarët e tij, të cilët duhen të jenë banorë të fshatit, zgjedhja e të cilit bëhet me vota të fshehta të Këshillit.

9. Këshilli dhe **Kryetari** i Këshillit ushtrojnë veprimtaritë e tyre në bazë të vendimeve të nxjerra nga Kuvendi i Komunës dhe në bazë të autorizimeve që ua jep ky Ligj.

10. Buxheti për themelimin dhe funksionimin e Këshillit ndahet në pajtim me Ligjin mbi Financat e **Pushtetit Lokal**, i cili i ofrohet Komunës si grant për kompetencat e shtuara.

11. Komuna aplikon lehtësira fiskale për personat fizik dhe juridik brenda zonës rurale të fshatit Zym sipas Ligjit për Trashëgiminë Kulturore.

Amendamenti 4

Në Nenin 5, riformulohet paragrafi 2 :

Komuna, në konsultim me institucionet përkatëse të trashëgimisë kulturore dhe në bashkëpunim me Këshillin hartojnë dhe miratojnë dokumentet e planifikimit për Fshatin në përputhje me Ligjin për Planifikimin Hapësinor dhe Ligjin për Trashëgiminë Kulturore.

Në paragrafin 4, fjala “**Qeveria Qendrore**” zëvendësohet me “**Autoritetet Qendrore**”.

Amendamenti 5

Në titullin e **Nenit 6** dhe në paragrafin 1 pas fjalës “**trashëgimisë**” fjala “**fetare dhe kulturore**” zëvendësohet me “**kulturore dhe fetare**”.

Në nënparagrafin 1.1. fjala **IKMM** zëvendësohet me “**Instituti për mbrojtjen e monumenteve të Prizrenit** dhe pas fjalës “**Ligjin**” fshihet “**Nr. 02/L-88/2006**”.

Amendamenti 6

Neni 7, në titull dhe në nënparagrafin 1.1. pas fjalës “**planifikimit**” shtohet fjala “**hapësinor dhe**”.

Amendamenti 7

Neni 8, riformulohet si në vijim :

Konservimi i strukturës dhe karakteristikave të veçanta të Fshatit

1. Me qëllim të ruajtjes së strukturës dhe karakteristikave të veçanta të Fshatit, në ZVM ndalohen këto aktivitete:

1.1. aktivitetet që do të rezultojnë në ndryshimin e përhershëm të profilit fizik të peizazhit natyror dhe kulturor;

1.2. ndërtimet apo zhvillimet që çojnë në shpyllëzimin ose ndotjen e mjedisit;

1.3. urbanizimi i tokës bujqësore ;

1.4. bashkimi i dy apo më shumë parcelave kadastrale në një njësi të vetme, përveç kur parcela është duke u kthyer në gjendjen e saj origjinale gjatë restaurimit, rindërtimit ose revitalizimit të ndërtesave tradicionale dhe monumentit që është nën mbrojtje;

1.5. vendosja e kiosqeve, tezgave, tavolinave dhe elementeve tjera montazhe, parkingjeve ose të ngjashme që do të pengonte vizurat dhe qasje të lirshme në monument si dhe vendosja e kontejnerëve dhe shportave tjera për mbeturina para dhe në afërsi të monumentit;

1.6. muzika me zë më të lartë se (shtatëdhjetë) 70 db, përveç gjatë ngjarjeve/organizimeve të natyrës publike, për të cilat merret paraprakisht leja prej Komunës;

1.7. vendosja e reklamave të përhershme, shenjave private, dekorimeve apo elementeve penguese me sipërfaqe më të madhe se një metër katror (1m²) dhe pa pëlqimin e Institutit për Mbrojtjen e Monumenteve të Prizrenit.

1.8. aktivitetet ndërtimore apo transformuese që do të rezultojnë në objekte me lartësi më të madhe se Përdhese + dy (2) etazhe (P+2); apo lartësia e të cilëve, e matur prej nivelit të terrenit natyror deri në nivel të vijës së strehës, tejkalon nëntë metra e gjysmë (9.5m); apo lartësia e tërësishme e të cilëve, e matur prej nivelit të terrenit natyror duke përfshirë çatinë dhe çfarëdo vazhdim tjetër fizik në objekt, tejkalon dymbëdhjetë metra e gjysmë (12.5m);

1.9. aktivitetet ndërtimore apo transformuese që do të rezultojnë me objekte ku sipërfaqja e përdhese tejkalon 150m², me përjashtim të rasteve të veçanta të rindërtimit apo rifunksionalizimit të objekteve publike, duke e respektuar karakteristikat e Fshatit, të cilat duhet të kalojnë po të njëjtat procedura të marrjes së lejes urbanistike nga Komuna dhe pëlqimit nga Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve të Prizrenit,

1.10. pompat e reja të derivateve të naftës si dhe ndërtimet industriale, fabrikat ose zhvillimet e ngjashme përfshirë eksploatimin e burimeve minerale dhe furrënalat;

1.11. funksionimi i kazinove, bastoreve dhe veprimtarive tjera të lojërave të fatit.

Amendamenti 8

Neni 9, riformulohet si në vijim :

Dispozitat kalimtare

Anëtarët e Këshillit zgjedhën brenda tre (3) muajsh nga hyrja në fuqi e këtij Ligji dhe vazhdojnë mandatin deri në zgjedhjet e ardhshme që zhvillohen në të njëjtën kohë me zgjedhjet lokale.

Pas rishikimit të këtyre amendamenteve nga kryetari me stafin, të njëjtat do të përcjellën komisioneve të përhershme .

4. Shqyrtimi i projektligjit për trajtimin e ndërtimeve pa leje

Kryetari Nait Hasani pasi që konstatoi se ky komision është duke shqyrtuar projektligjin në fjalë, shtoi se vizita që do të realizohet në Kroaci do të ndihmoi shumë për trajtimin sa më të mirë të këtij projektligji, pasi që Kosova pothuaj se ka më së shumti nevojë për këtë ligj, ndaj falënderoi Lirije Berishën nga MMPH për prezencën dhe kërkoi disa sqarime shtesë rreth këtij projektligji.

Drejtoresha **Lirije Berisha** gjithashtu mendoi se në Kroaci komisioni ka shumë gjëra për të qartësuar lidhur me trajtimin dhe përvojën e zyrtarëve të atjeshëm për këtë projektligj, mirëpo pasi që zyrtarët e MMPH gjithashtu kanë vizituar homologët në Kroaci, ajo sugjeroi që komisionit t'ia përcjellë materialin nga vizita në mënyrë elektronike anëtarëve të komisionit. **Kryetari** falënderoi dhe kërkoi nga stafi që materialin që do ta dërgojnë zyrtarët e MMPH t'ua përcjellë anëtarëve të komisionit.

5. Të ndryshme

Në këtë pikë **Kryetari** potencoi çështjet si vijon :

1. Lidhur me kampin turistik të përkohshëm në Prevallë, kryetari njoftoi se banorët e atjeshëm kanë filluar të parashtrojnë ankesa për shkak të veprimeve të MMPH për rrënimin e tyre, përkatësisht shtëpizave ku ata jetojnë. Ky kamp është ndërtua me masa të përkohshme vetëm për 3 muaj, mirëpo kompania menaxhuese ju ka lejuar këtyre banorëve ndërtime te forta, ndaj MMPH ka marrë vendim për heqjen e kampit në afat kohor prej 15 ditësh.

2. **Daut Haradinaj** shprehu shqetësimin për dëmet e shkaktuara nga breshëri në Komunën e Gjakovës , Rahovecit dhe të Istogut. Ministria dhe Komuna poashtu kanë premtuar publikisht dhe kanë bërë hulumtimet dhe verifikimet, të gjitha dosjet janë dorëzuar tash e disa muaj në Ministrinë e Bujqësisë dhe asnjëher asnjë përgjigje nuk ju është kthyer banorëve, ndaj kërkoi nga Komisioni të intervenohet tek Ministri i bujqësisë ose përmes grupeve parlamentare të hyj kjo çështje si pikë në seancën e radhës.

Nait Hasani falënderoi deputetin Daut Haradinaj për informata por kërkoi që komisioni do të ishte mirë të furnizohet me materialet apo të dhënat e cekura për të adresuar shkresën në MB se ku është qështja e mosmbulimit të damëve që janë bërë.

Mbledhja përfundoi në orën 13,00.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Nait Hasani